



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

5 DHJETOR 2025 / JURIA KA PËRZGJEDHUR ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2024



19 DHJETOR 2025 / RITA PETRO - SHPALLET "POETE LAUREATE"



2 dhjetor 2025 / Fondi i Krijimtarisë Letrare Për Të Rinj mbështet autorët e rinj:

"Testosteron" nga Arbër Selmani
"Pesë vdekje" nga Antonio Çikollari
"Vdekja e kukullës" nga Liza Brozi
"Anahera: E fshehta në godinën e pestë" nga Xhensila Dautllari

15 dhjetor 2025 / Portreti i një intelektualit të vërtetë: ROBERT PRIFTI - 100-vjetori i lindjes së tij



19 dhjetor 2025 / Letërsia e Autorëve Të Rinj





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

5 DHJETOR 2025 / JURIA E PËRBËRË NGA Z. BESNIK MUSTAJ (KRYETAR) DHE ME ANËTARË: ZNJ. DHURATA SHEHRI, ZNJ. ELSA SKËNDERI RAKIPLARI, ZNJ. MAKLENA NIKA DHE ZNJ. FATMIRA NIKOLLI KA PËRZGJEDHUR

ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2024



ENIT KARAFILI (AUTOR) - "EPOPE INTIME"

Enit Karafili është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e përbërë nga z. Besnik Mustafaj (kryetar) dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli ka përzgjedhur romanin "Epope intime" nga Enit Karafili (Botimet Pegi) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.

Rreth autores dhe përmbajtjes së librit:

Enit Karafili Steiner, shkrimtarja shqiptare që jeton në Zvicër, pas dy romaneve të para "Tokëmjalta" dhe "Dhunë e dhunti", vjen me këtë sagë të paharrueshme shqiptare, ku

malli dhe dashuria për atdheun lidhen me fije të padukshme me mallin dhe dashurinë për njerëzit.

E kush nuk ka thurur plane të panumërta për të lënë pas Shqipërinë njëherë e përgjithmonë e për të ndërtuar një jetë të re diku tjetër? Marla dhe Marini, ende në prag të jetës, kushërinj të lidhur në mënyrë "mëkatore" me njëri-tjetrin, largohen nga Shqipëria e 1995-ës. Ai i kthen krahët vendlindjes me padurim, ajo me kokën pas; ai ndjek studimet për aviacion në Maltë, ajo zgjedh sociologji në një tjetër ishull. Para se të ndahen, premtojnë se kurrkush e kurrgjë nuk do t'ua zbehë dashurinë që i ka lidhur qysh

në fëmijëri, sepse do ta ruajnë të paprekur si në një kasafortë. Koha ecën, por disa ëndrra u ngjajnë ende atyre të dy dekadave më parë dhe ata, tashmë larg njëri-tjetrit, pyesin veten: "E kemi mbajtur, vallë, premtimin?" Historia e tyre të fton ta kërkojnë përgjigjen në dy jetë që shtjellohen prej adoleshencës në pjekuri, mes lindjes dhe perëndimit, dashurive dhe pengjeve. Ky libër përçon shkëndija prej shpirtit të tranzicionit shqiptar, rrëfen dështimet e triumfet, siç gjallojnë në dy njerëz të dashuruar, të ndarë e të lidhur si gerrat e një epopeje.

6 DHJETOR 2025 / FINALISTË: VIRGJIL MUÇI (AUTOR) - "TRI JETËT E ZOTIT P."

Virgjl Muçi është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj.

Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin "Tri jetët e zotit P." nga Virgjl Muçi (Botimet



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Ditura) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.

Rreth përmbajtjes së librit:

“Tri jetët e zotit P.” është një roman për dashurinë.

Dashurinë e pakufishme dhe të patjetërsueshme të një njeriu për pushtetin mbi qeniet njerëzore në shprehjen e vet më të plotë, jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht. Për hir të këtij misioni, Zoti P. kuturiset e ndërmerr një udhëtim të

pazakontë në tri botë: atë të vdekatarëve të rëndomtë, pra Toka; atë të hijeve të përjetshme, Nëntoka; për t’u ndalur në stacionin e fundit, aty ku shtrëngohet të paguajë haraçin: mohimin e vetvetes, për të siguruar përjetësinë. Në qoftë se marrëdhënia e zotit P. me pushtetin është diçka sublime, marrëdhëniet e tij me qeniet e tjera njerëzore janë më të koklavitura dhe rrokin një

dimension tragjiko-komik. Rreth zotit P. gëlon një mizëri njerëzish: bashkëpunëtorë, të dashura, ish-miq e shokë, familja madje, që në sytë e tij nuk janë veçse vartës, qenie servile dhe hipokrite që synojnë ta mashtrojnë dhe, në një mënyrë ose një tjetër, t’i rrëmbejnë atë çka është jetike për të: Pushtetin.



8 DHJETOR 2025 / FINALISTË: AIDA BARO (PËRKTHYESE) - “JETA E SHKURTËR E LUKAS SANTANËS”



Aida Baro është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Jeta e shkurtër e Lukas Santanës” nga autorja Elvira Dones dhe përkthyer nga Aida Baro (Botimet PEGI) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.

Rreth përmbajtjes së librit:

Lukas Santana është një gangster i ri me origjinë meksikane, ushtar i thjeshtë i një prej

bandave më të egra të Rio Grandes, në Teksas. I dënuar padrejtësisht me vdekje,

ndonëse nuk ka vrarë askënd, i kalon dhjetë vitet e fundit të jetës i mbyllur në qeli, në pritje



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

të ekzekutimit. I zhytur në dëshpërim, do të orvatet disa herë të kryejë vetëvrasje. Pranë do t'i qëndrojnë njerëz me humanizëm të jashtëzakonshëm. Mbi të gjitha, Beatris Masedo, e cila do të heqë dorë nga ëndrrat e saj rinore për ta shoqëruar Lukasin në të mirë e në të keq,

për hir të dashurisë së marrë që ndien për të. “Jeta e shkurtër e Lukas Santanës” nuk është thjesht një roman, por historia e vërtetë e një djaloshi teksan, të cilin Donesi e ka shoqëruar përgjatë verës së mbrame të jetës së tij. Ai është një reflektim mbi dënimin kapital dhe

mënyrat perverse të shfrytëzimit të sistemit të drejtësisë, mbi kthesat ogurzeza të fatit dhe përpjekjet e dëshpëruara të shtresave të marginalizuara për të kaluar një prag të pakapërcyeshëm, një pasqyrë e vetëmohimit të grave në çfarëdolloj sistemi.

9 DHJETOR 2025 / FINALISTË: ELDA GJANA (PËRKTHYESE) - “SHTËPIA E FUNDIT PARA MALIT” ME AUTORE MONIKA HELFER



Elda Gjana është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin “Shtëpia e fundit para malit” nga autorja Monika Helfer dhe përkthyer nga Elda Gjana (Botimet Dituria) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit. *Rreth përmbajtjes së librit:*

Monika Helferi na dhuron një roman të fuqishëm, me një prozë me intensitet të rrallë, që na çon në një botë rurale e të ashpër dhe që rrëfen për barrën që rëndon në historinë e çdo familjeje. Shtëpia e fundit para malit është cilësuar si një rast editorial original në botën gjermane, duke fituar zemrat e të

gjithëve: kritikëve, lexuesve dhe librarëve.


Jozef dhe Maria Mozbrugeri jetojnë me pesë fëmijët e tyre në të dalë të një fshati të vogël në një luginë të largët në malet austriake. Janë të varfër, të padëshiruar dhe askush nuk i do pranë, përveç kryetarit të bashkisë. Kur shpërthen lufta, në vitin 1914, dhe Jozefi rekrutohet

e dërgohet në front, Maria dhe fëmijët mbeten fillikatisht.

Një ditë, në derën e Marisë troket Georgu, një i huaj që flet një gjermanishte shumë ndryshe nga ata. Sapo gruaja mbetet shtatzënë, nisin të gëlojnë thashethemet dhe xhelozia, që përhapen me shpejtësi. Çfarë do të ndodhë kur Jozefi të kthehet nga fronti?

10 DHJETOR 2025 / ALBAN TUFA (AUTOR) - “PO SIKUR TË MOS JETË ËNDËRR?”

Alban Tufa është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Po sikur të mos jetë ëndërr?” nga Alban Tufa (Botimet Toena) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë. Fragment nga libri:
Ç’të qe e gjitha kjo? Një makth? Një çudi që i është shpifur nga

një botë e përkundërt e nxitur nga kushedi se cili hakmarrës. Nuk kishte parë kurrë me parë një ëndërr, madje as kishte ndier turbullirën më të vogël përgjatë gjumit. I kishte qëndruar besnik kësaj rrjedhe të gjërave, pa u dalë në shmang, qoftë edhe pavetëdije. Kjo qe hera e parë që e kapte veten duke menduar kaq gjatë dhe kaq thellë tek përsiatej mbi një ngjarje. Ishte shastisur

me veten se si një njeri në Qytetin e Blertë mund të shihte diçka jashtë ekranit dhe jashtë botës reale e sakaq këtë ta bënte në mënyrën më absurde, me sy mbyllur. T’i kishte me të vërtetë sytë e mbyllur? E nëse po, atëherë si u shpërfaqën në sytë e tij ato imazhe të njëpasnjëshme, duke u dhënë pamje pas pamje si në një ekran.



11 DHJETOR 2025 /FATE VELAJ (AUTOR) - “MOSSANGA”




Fate Velaj është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga

juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024. Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Mossanga” nga Fate Velaj (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.
Rreth përmbajtjes së librit:

... Ai ishte një “vlonjat” që këndonte me kitarë këngët e dashurisë.

Ishte një “shqiptar” që recitonte plot ndjenjë vjershat e Naimit. Ishte më i përvëlui nga dielli i korrikut dhe më i nxiri nga ai i gushtit, por, mbi të gjitha, ishte djaloshi më i buzëqeshur që mbaj mend nga fëmijëria ime...





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

14 DHJETOR 2025 / ILJAZ SPAHIU (PËRKTHYES) - “NJERIU QË SHET GJAK” ME AUTOR YU HUA

Iljaz Spahiu është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Njeriu që shet gjak” nga autori Yu Hua dhe përkthyer nga Iljaz Spahiu (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.

Rreth përmbajtjes së librit:

Si një nga dhjetë librat më me influencë të dekadës së fundit në Kinë, ky roman i vlerësuar ndërkombëtarisht, shkruar nga një prej shkrimtarëve më të mirë bashkëkohorë të Kinës, paraqet një portret të guximshëm të jetës nën kryetarin Mao.

Xu Sanguan, një shtytës karroce në një fabrikë mëndafshi, shton të ardhurat e pamjaftueshme duke shkruar rregullisht të shesë gjak. Vajtjet i bëhen tmerrësisht të shpeshta, teksa orvatet të mbajë gruan dhe tre djemtë e tij

në kulmin e Revolucionit Kulturor. Ai shkatërrohet kur zbulon se djali i preferuar në fakt ishte pjellë e një marrëdhënieje të fshehtë midis gruas së tij dhe një fqinji, provon çnderimin më të madh, kurse gruaja e tij qortohet publikisht si një prostitutë.

Megjithëse varfëria dhe tradhtitë e regjimit Mao e kanë shterruar, Xu Sanguan në fund gjen forcë në lidhjet e gjakut me familjen e tij.



15 DHJETOR 2025 / ANILA MULLAHI (STUDIUESE) - “KRIJIMI LETRAR NË PROCES”

Anila Mullahi është një prej 10 studiuesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin studimor “Krijimi letrar në

proces” nga studiuesja e letërsisë Anila Mullahi (Botimet Pegi) si finalist për Çmimin e madh të Studimeve.

Mbi librin:

Objekt kërkimor i këtij studimi është rrugëtimi krijues i disa prej veprave në prozë të shkrimtarit të njohur shqiptar, Dritëro Agolli. Studimi gjenetik mbi romanet e Agollit merr në

analizë materialet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tekstin përfundimtar: tregime, novela që më vonë zgjerohen në romane, si dhe me dorëshkrimet e romaneve, por edhe me materiale që lidhen me të në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, siç janë blloqet e shënimeve, letërkëmbimet etj.



QKLL 2025

DHJETOR




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Pjesa më e rëndësishme e studimit ka të bëjë me analizën e detajuar të dorëshkrimeve të ruajtura me shumë kujdes prej shkrimtarit. Agolli i ka vlerësuar dhe, në pjesën më të madhe të rasteve, i ka ruajtur

dorëshkrimet e tij me shumë kujdes. Ka ruajtur dorëshkrimet e romaneve "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", "Arka e djallit", "Kalorësi lakuriq". "Trëndafili në gotë etj. Analizat e detajuara të

dorëshkrimeve janë shqyrtime sistematike gjenetike, të cilat, me shumë sesa synojnë të tregojnë si lindin veprat letrare, ndihmojnë në interpretimin e tyre.



17 DHJETOR 2025 / MATTEO MANDALÁ (STUDIUES) - "NË PERIFERINË E ISMAILANDIT"

Matteo Mandala është një prej 10 studiuesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin studimor "Në periferinë e Ismailandit" nga studiuesi

Matteo Mandala (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Studimeve.

Mbi librin "Në periferinë e Ismailandit" është shembulli se si nëpërmjet qasjeve sinkronike dhe diakronike, mund të vështrohet krijimtaria e një shkrimtari si shprehje estetike dhe njëkohësisht, si ravijëzim

edhe i vendit të atij shkrimtari në historinë e letërsisë, po ashtu i mënyrës si historia kombëtare dhe historia letrare komunikojnë njëra me tjetrën. Me këtë vepër, profesor Matteo Mandala na siguroi sërish se është më i zoti ndër topografë për krijimin e një harte të Ismailandit".





QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


DHJETOR



19 DHJETOR 2025 / DURIM TAÇI (PËRKTHYES) - "PORTOKALL ME KURDISJE" ME AUTOR ANTHONY BURGESS

Durim Taçi është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin "Portokall me kurdisje" nga autori Anthony Burgess dhe përkthyer nga Durim Taçi (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit. Rreth përmbajtjes së librit:



Një vizion i makthshëm ndikues të së ardhmes të Anthony Burgess-it, ku natën vijnë kriminelët në pushtet, historia rrëfëhet nga personazhi kryesor, Aleksi, një adoleshent që flet në një zhargon të shpifur fantastik, që përçon fuqishëm reagimet e tij dhe të miqve të tij kundër shoqërisë së tyre. Marramendës dhe transgresiv, Portokall me kurdisje është një fabulë e frikshme për të mirën dhe të keqen si dhe mbi kuptimin e lirisë njerëzore.

20 DHJETOR 2025 / NDUE UKAJ (AUTOR) - "SHTEGU I TË VERBËRVE"



autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur vëllimin me tregime "Shtegu i të verbërve" nga Ndue Ukaj (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë. Fragment nga libri:

Në mjegull nuk sheh asgjë, thoshte ndonjëri me tru më të kthjellët, atyre mëngjeseve të bukura, por zërat e tillë ngjanin si britma që i gllabëron te zhurmëri a. Mbizotër onte



Ndue Ukaj është një prej 10



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

frikë e madhe, më e madhe se
mjegulla dhe më e paqartë se
vetë paqartësia, ndaj, njerëzit
ngjisheshin me njëri-tjetrin e
bëheshin tufë e tufa i
asgjësonte njerëzit, emrat e
mbiemrat e njerëzve nuk kishin

më ndonjë kuptim, turma i
shkrinte njerëzit në pjesëtarë
të tufës, dhe në çaste të tilla,
njerëzit nënshtroheshin
lehtësisht, siç nënshtroheshin
gjëja e gjallë. Ku të gjeje kush
ku është në këtë tufë, në të

cilën, po të flisje për ndonjë ves
shoqëror, ngjante sikur
pëshpërisje në mes të një
shtrëngate. A ishte kjo një
ëndërr e keqe a zhgjendërr e
trishtë.

22 DHJETOR 2025 / ROMEO ÇOLLAKU (PËRKTHYES) - “RETORIKA” NGA ARISTOTELI



Romeo Çollaku
është një prej 10
përkthyesve të
përzgjedhur nga
juria e Çmimeve
Kombëtare të
Letërsisë për vitin
2024.

Juria e kryesuar
nga z. Besnik
Mustafaj dhe me
anëtarë: znj.


Dhurata Shehri,

znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika
dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin
“Retorika” nga Aristoteli dhe përkthyer nga
Romeo Çollaku (Botimet Albas) si finalist për
Çmimin e madh të Përkthimit.

Mbi librin:

Retorika është e dobishme, edhe sepse, prej
natyre, e vërteta dhe e drejta përmbajnë më

tepër forcë sesa të
kundërtat e tyre. (...) Le
ta pranojmë se retorika
është aftësia për të gjetur
në çdo çështje,
argumentet që mund të
bindin. Asnjë art tjetër
nuk merret me këtë
punë. Çdo art tjetër
ushtron dhe dikton
bindje në lidhje me
objektin e veçantë me të
cilin merret. Mjekësia, fjala vjen, për çështje të
shëndetit dhe të sëmundjeve, gjeometria për
cilësitë e madhësive, aritmetika për numrat dhe,
kështu me radhë, gjithë artet e shkencat e tjera.
Mirëpo, retorika duket se është e aftë të gjejë
elementet që mund të bindin, për çdo çështje që
na intereson.



24 DHJETOR 2025 / AGRON TUFA (AUTOR) - “NJERIU BUZË LUMIT”

Agron Tufa është një prej 10
autorëve të përzgjedhur nga
juria e Çmimeve Kombëtare të
Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik
Mustafaj dhe me anëtarë: znj.

Dhurata Shehri, znj. Elsa

Skënderi Rakiplari, znj.

Maklena Nika dhe znj. Fatmira
Nikolli e ka përzgjedhur
vëllimin poetik “Njeriu buzë

lumit” nga Agron Tufa (Botimet
Onufri) si finalist për Çmimin e
madh të Letërsisë.

Mbi librin:

Atdhe m’u bënë idetë që i
ngroh ëmbël në kllloçkë
me kurmin e mërdhirë, në
folenë më të lartë
të kavakut dimëror, të
zhveshur, pilirak –

si një klithmë me penel mes
trishtimit fusharak.
Idetë m’u bënë Atdhe, i dehur
me vetmi
në folenë më të lartë, ku nuk
ngjitet asnjëri,
ku i kaltri gjak venoz mezi
shtyhet pikë-pikë,
ku dhe kllloçka e pangrohur në
fole, ka rrezik



QKLL 2025


DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

mos me çelë zogj të gjallë. Për një stinë. Për një vit.

Për një jetë që përpëlitet me Atdheun-kockë në fyt.



26 DHJETOR 2025 / LORAN GAMI (STUDIUES) - "SFIDA ESTETIKE E SAMUEL BEKETIT"



Loran Gami është një prej studiuesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024. Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin "Sfida estetike e Samuel Becketit" nga Loran Gami (Botimet Dituria) si finalist

për Çmimin e madh të Punimi Studimeve. është i ndarë në Mbi librin: ndarë në Sot, edhe pas shumë gjashtë dhjetëvjeçarësh nga koha kur u kapituj, në krijua, i gjithë opusi i Samuel të cilët Becketit vazhdon të lexohet, të trajtohen diskutohet e të vihet në skenë në me radhë: konteksti kulturor e të gjithë botën. Kjo dëshmon se intelektual i kohës, ngjizja e dalja në skenë e Teatrit të Absurdes; vepra e tij nuk ishte thjesht një aspekte kryesore të estetikës në trill i kohës, por një vepër me një veprën e Becketit, disa nga aspektet më të rëndësishme forcë të tillë estetike, që i tejkalon kufijtë e kohës kur lindi dhe u zhvillua. filozofike në veprën e Libri është mbështetur kryesisht shkrimtarit; çështje të mbujtjes në punimin e doktoratës së Dr. së psikologjisë së personazheve Gamit, natyrisht, duke shtuar e dhe raportit që kanë me modifikuar ide e fragmente të realitetin; ndërtimi i dramave të ndryshme. Pasazhet e veprave të Becketit; analizimi i gjuhës në cituara në të janë përkthyer nga veprën e tij, duke trajtuar vetë autori, çka, krahas posaçërisht ndikimet që mund të vështirësisë së trajtimit të një ketë pasur ai nga mendimtarë si shkrimtari të tillë si Becketi, ka Ludvig Vitgenshtajni dhe Fric qenë një sfidë më vete. Mautneri.





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

27 DHJETOR 2025 / ARBEN DEDJA (AUTOR) - “MUZAT E MIA TRUPORE”



Arben Dedja është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve

Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024. Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur vëllimin me tregime “Muzat e mia trupore” nga Arben Dedja (Botimet Pika pa sipërfaqe) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.

Fragment nga libri:

Tani, në këto tekste nganjëherë të gjata, fluviale, thelbi i rrëfimit, herë paturpësisht eksplicit, herë i mbuluar si thëngjill nën hi, përfshin tërësinë e këtyre funksioneve – shumë gjëra, siç do të mund ta konstatoi edhe vetë –: gërhitjen, gogësimën, gromësirën, gudulisjen, kollën, të kruarën, lemnën, shtrijën.



28 DHJETOR 2025 / KORAB HOXHA (PËRKTHYES) - “VDEKJA E NJË PINGUINI” NGA ANDREJ KURKOV



Korab Hoxha është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.


Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Vdekja e një pinguini” nga Andrej Kurkov dhe përkthyer nga Korab Hoxha (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.

Mbi librin:

Gjithçka që qëndron mes një burri dhe vrasjes nga mafia është një pinguin.

Viktori, një burrë që aspirojnë të jetë shkrimtar, ka vetëm Mishën, pinguinin e tij, për shoqëri. Megjithatë do t'i pëlqente të shkruante tregime të shkurtra, ai e fiton jetesën duke hartuar nekrologji për një gazetë. Mezi pret t'i shohë

shkrimet e tij të botuara, por çuditërisht, subjektet e nekrologjive të tij vazhdojnë të mbeten gjallë. Kur për herë të parë çel gazetën, që ta lexojë të shtypur punën e tij, krenaria i shndërrohet në terror: Ai dhe Misha kanë rënë në një kurdh nga i cili duket se nuk shpëtojnë dot.





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

28 DHJETOR 2025 / BALLSOR HOXHA (AUTOR) - "BORA DHE UNË"



Ballsor Hoxha është një prej 10

autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin "Bora dhe unë" nga Ballsor Hoxha (Botimet Onufri) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.

Mbi librin:

Roman? Rrëfim? Bredhje? Të qenët i hedhur nga asgjëja në

asgjë? Arritur në neuropsikiatri të Prishtinës në fund, prej nga edhe sapo kam dalë dhe po rrëfej, se si, tërë këtë kohë më duket se po e përjetoj veten si një tetër, e ai po vazhdon jetën, në një ëndërr tejet të largët për mua, në ëndrrën e tij.



28 DHJETOR 2025 / DAUT GUMENI (AUTOR) - "DITARI I NJË SAMARPUNUESI"



Daut Gumeni është një prej 10 autorëve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin "Ditari i një Samarpunuesi" nga Daut Gumeni (Botimet M&B) si finalist për Çmimin e madh të Letërsisë.

Mbi librin:

Fabula e romanit "Ditari i një samarpunuesi" me autor Daut Gumenin është një gjetje e jashtëzakonshme. Ngjarjet zhvillohen në një rreth të jugut të Shqipërisë komuniste, më saktë në një kooperativë ku është ngritur një ndërmarrje ku prodhohen samarë për kafshët

e punës; kuaj, mushka, gomerë. Kjo ndërmarrje shërben njëkohësisht edhe si kurs për të mësuar rioshët mjeshtërinë e samarpunuesit apo samarxhiut, si quheshin dikur. Por përpara se të bëjnë samarët për kafshët e punës kursantët duhen të përgatiten e të përshtatin samarët për vete në radhë të parë, sidomos ata "të pabindurit", "me njolla në biografi", kundërshtarët e regjimit të kohës...





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

29 DHJETOR 2025 / ERION GJATOLLI (PËRKTHYES) - “SHKRIME KUSARE” NGA PIER PAOLO PASOLINI



Erion Gjatolli është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin “Shkrime kusare” nga Pier Paolo Pasolini dhe përkthyer nga Erion Gjatolli (Botimet Dudaj) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.

Mbi librin:

Unë nuk kam pas vetes asnjë lloj autoriteti: përveç atij, që në mënyrë paradoksale, më jep vetë fakti që autoritet nuk kam dhe nuk kam dashur asnjëherë; nga fakti se e kam vënë veten në një pozitë të tillë ku të mos kem asgjë për të humbur, pra që të mos kem detyrimin t’i qëndroj besnik asnjë pakti veç atij me lexuesin, të cilin e konsideroj të denjë për hulumtime, edhe nga ato më skandalozet”. Revolucionari i padukshëm konformist, për të cilin Pasolini foli me kaq ngulm dhe dhimbje nga viti 1973 deri më 1975, nuk ishte aspak një fenomen i padukshëm. Kushdo që kujton në mënyrë sado të vagët polemikat gazetareske të kohës mund të habitet duke lexuar këto “Shkrime kusare”.



29 DHJETOR 2025 / SAVERINA PASHO (PËRKTHYESE) - “FESTA E KOTËSISË” NGA MILAN KUNDERA



Saverina Pasho është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Mbi librin:

Të hedhësh dritë mbi problemet më serioze dhe në të njëjtën kohë të mos shqiptosh asnjë fjali të vetme serioze, të magjepsesh nga realiteti i botës bashkëkohore dhe në të njëjtën kohë të shmangësh çdo realizëm - ja, kjo është Festa e kotësisë.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli ka përzgjedhur librin “Festa e kotësisë” nga Milan Kundera dhe përkthyer nga Saverina Pasho (Botimet Dituria) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.





QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

DHJETOR



30 DHJETOR 2025 / FLAVIA KABA (PËRKTHYESE) - "MISHI ËSHTË I BUTË" NGA AGUSTINA BAZTERRICA



Flavia Kaba është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024. Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa

Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur romanin "Mishi është i butë" nga Agustina Bazterrica dhe përkthyer nga Flavia Kaba (Botimet Aleph) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.

Mbi librin:

Mishi është i butë është një roman distopik horror nga shkrimtarja argjentnase Agustina Bazterrica, i botuar fillimisht më 2017. Romani paraqet një shoqëri në të cilën një virus ka kontaminuar të gjithë mishin e kafshëve. Për shkak të mungesës së mishit të

kafshëve, kanibalizmi bëhet i ligjshëm.



30 DHJETOR 2025 / VIOLA ISUFaj (STUDIUESE) - "BALADË DRITASH PËR ZORBËN"



znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin "Baladë dritash për Zorbën" nga Viola Isufaj (botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë) si finalist për Çmimin e madh të Studimeve.

Viola Isufaj është një prej studiuesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024. Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri,

Rreth librit:

Në gjysmën e dytë të një shekulli plot përshtjellime politike, të cilat nuk lanë pa prekur e dëmtuar trungun e letërsisë shqipe, bën jetë në errësi për t'u shfaqur më pas, në dritë, ky poet, i cili sjell një nga modelet më të pangjashme të shkrimit të poezisë moderne shqipe.

Pastërtia e pabesueshme në përdorimin e teknikave në realizimin e virtuoizeteve të tij poetike, e bën atë një klasik modern...





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

30 DHJETOR 2025 / SUADELA BALLIU (PËRKTHYESE) - “DETI I LASHTË I BOTËS” NGA HILDA HIST

Suadela Balliu është një prej 10 përkthyesve të përzgjedhur nga juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2024.

Juria e kryesuar nga z. Besnik Mustafaj dhe me anëtarë: znj. Dhurata Shehri, znj. Elsa Skënderi Rakiplari, znj. Maklena Nika dhe znj. Fatmira Nikolli e ka përzgjedhur librin me poezi “Deti i

lashtë i botës” nga Hilda Hist dhe përkthyer nga Suadela Balliu (Botimet Aleph) si finalist për Çmimin e madh të Përkthimit.



Rreth librit:

*Një grua pezull mes lakimeve dhe dhëmbëve
Shpend i lashtë, kukull me pendë
Flatrat që mendoj se i ishin këputur.
Larë prej dritash, një zot më tund.
Shpërfillës. Gërhitës.*



23 DHJETOR 2025 / RITA PETRO - SHPALLET “POETE LAUREATE”



Rita Petro u shpall “Poete Laureate” për dyvjeçarin 2025-2027.

Poetes iu dha titulli “Poeti Laureat” me motivacionin: “Në krijimtarinë e saj prej afër tri dekadash në lëvrimin e poezisë shqipe, ajo ka përcjellë origjinalitet në trajtimin e

temave të guximshme, me sinjeritet intelektual dhe me kapërcime e tronditje të tabuve konvencionale e të vjetra moralistike. Poezia e Petros përcillet si provokuese, që çliron energji ndikuese për emancipim individual dhe shoqëror”. Juria që përzgjedhi Poetin Laureat përbëhej nga z. Primo Shllaku (kryetar), z. Ymer Çiraku (anëtar), z. Aleksandër Cipa (anëtar), znj. Majlinda Rama (anëtare), z. Koloreto Cukali (anëtar).

Nga PRIMO SHLLAKU

Një juri pesëvetëshe e përbërë prej prof. Ymer Çirakut, Majlinda Nana-Ramës, Aleksandër Çipës, Koloreto Cukalit dhe Primo Shllakut si kryetar i saj, juri kjo e ngarkuar prej QKLL-së për

përzgjedhjen dhe zgjedhjen e Poetit Laureat të Republikës së Shqipërisë për vitet 2026-2027, vendosi me shumicë votash që Laureate e këtij dyvjeçari të jetë poetja e mirënjohur, Rita Petro. Rita Petro e filloi veprimtarinë e saj krijuese si brezni e mbasndryshimit të sistemeve, pra mbas viteve '90 dhe qysh atëherë ajo ka qenë aktive, prodhimtare dhe madje edhe befasuese me krijimet e saj sa i përket tematikave, intencave letrare dhe tronditjes që ajo ka sjellë në botën e lexuesit shqiptar të mbarë trojeve. Fillimisht ajo botoi në shtypin e shkruar ditor dhe më vonë filloi t'i përmbledhte krijimet e saj në vëllime. Është autore e vëllimit poetik “Vargje të përfoluna” (1994), e



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

vëllimit "Shija e instinktit" (1998), e vëllimit provokues "Vrima", e vëllimit tjetër "Kënga e Turmës", e një biografie shumë interesante me anë të së cilës ajo përpiket ta shpjegojë temperamentin e saj letrar dhe që mban titullin "Lindur së prapthi". Po kështu në panairin e nëntorit të këtij viti, ajo erdhi përsëri me një megapoemë të titulluar "Poema e mungesës", e cila ka gjithkund tingëllime e përshkrime personale, të cilat shuhën në tekst për t'i lanë vendin meditimeve dhe konkluzioneve universale të autores.

Për spikamën e saj në fushën e letrave gjatë viteve ajo është shpërblye me Çmimin kombëtar të Biblio-filisë "Lumo Skëndo", më 2014.

Nji vit më vonë, pra më 2015, ajo merr Çmimin e Karrierës për krijimtarinë poetike.

Kurse më 2025 asaj i akordohet Çmimi "Beratinus" me motivacionin "figurë frymëzuese për brezat e ri".

Gjithashtu Rita Petro ka qenë e nominueme për çmim kombëtar më 2014 për vëllimin e saj

poetik "Vrima". Po ashtu më 2022 u nominue për çmim kombëtar për romanin e saj autobiografik "Lindur së prapthi".

Së fundmi ka qenë e nominueme për çmimet europiane të letërsisë 2024 (EUPL) po për romanin "Lindur së prapthi". Rita Petro hyni në letërsi me vrull provokues si pjesë e atij brezi që kërkonte një ndjeshmëri tjetër larg shabllonizimeve moralizuese të metodës së realizmit socialist. Letërsia e saj erdhi si një letërsi antropocentriste që kishte në qendër njeriun si frymë, si epokëkrijues e jo si epokëpësues. Ajo derdhi pa hesap në letrat e saj një sineritet që letërsisë shqipe ndoshta i kishte mungue gjithmonë. Zhveshja në publik e idhujve të dikurshëm, përdorimi i sineritetit si një armë sa paqësore aq edhe tronditëse, çmitizimi i tabuve dhe çmistifikimi i anatomisë njerëzore dhe i hipostazës psikike që e mbështjell atë, duket se ka qenë intencë ma e fortë dhe ma suksesplotë e saj në rrjedhë të dhjetëvjetëshit të dytë

të këtij shekulli. Rita mbetet një poeteshë e erotizmit dhe na duket se kësaj ajo kërkon të plotësojë një mungesë të madhe të letrave shqipe të cilat, megjithë adhurimin e shfaqun për folklorin, në këtë pikë qëndruen larg tij me pretekste moralistike dhe jo estetike. Përveç këtyre Rita Petro është një biznesmene e suksesshme e botës së botimit. Ajo mbetet e lidhur me librin, me botimet e teksteve shkollore, përkthimet e përkthyesit. Ka qenë e mbetet një nga poetet ma aktive në përhapjen e librit, në zhvillimin e diskurseve publike lidhë me problemet ma aktuale të letërsisë, tue dhanë kontribute të pazakonshme në promovimin e librit dhe të letërsisë bashkëkohore të asaj vetë dhe të kolegëve të saj. Për të gjithë ne që merremi me shkrime, Shtëpia botuese ALBAS ka qenë e mbetet një strehë e dashun leximesh, diskutimesh me frymë kritike dhe përfitimesh të bukura estetike.

E gëzofsh, Rita, titullin e Laureates!





QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

2 DHJETOR 2025 / FONDI I KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ MBËSHTET AUTORËT E RINJ



“Fati i letërsisë. Dilema e saj. Të shkruash në një botë ku fjala është mjet pushteti dhe mjet përmbysjeje.”
-Arbër Selmani

Disa nga titujt e mbështetur nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nëpërmjet Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj:

“Testosteron” nga Arbër Selmani

“Pesë vdekje” nga Antonio Çikollari

“Vdekja e kukullës” nga Liza Brozi

“Anahera: E fshehta në godinën e pestë” nga Xhensila Dautllari.



15 DHJETOR 2025 / PORTRETI I NJË INTELEKTUALI TË VËRTETË: ROBERT PRIFTI - 100-VJETORI I LINDJES SË TIJ

U mbajt në mjediset e Qendrës “Sotir Kolea” aktiviteti me temë “Portreti i një intelektual të vërtetë” organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, ku morën pjesë prof. Viola Isufi dhe z.Spartak Topollaj, të cilët folën mbi jetën dhe krijimtarinë prozaike dhe poetike të autorit Robert Prifti. Pjesë e këtij aktiviteti u bënë edhe prof. Artan Fuga, Visar

Zhiti, Nevruz Maluka dhe studiuesi italian, Mauro Geraci, nëpërmjet video-mesazheve dhe intervistave të realizuara nga gazetarja Beti Njuma. Aktiviteti për Robert Priftin, i cili u realizua në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së tij, u zhvillua në mjediset e Qendrës “Sotir Kolea”. Robert Prifti është një figurë disidente në letrat shqipe, pak e njohur ndër nesh që ka

shkruajtur në gjuhën italiane. Njohës i disa gjuhëve të huaja, si: frëngjishtja, rusishtja, latinishtja dhe greqishtja e vjetër, poliglot, dhe kimist me profesion. Përgjatë viteve të diktaturës ai u njoh si mësues i disa lëndëve shkencore, si dhe i gjuhëve të huaja. Por në më shumë se 4 dekada të diktaturës, gjatë të cilave ai jetoi, kishte shkruar një varg veprash në prozë dhe poezi, të gjitha në gjuhën italiane, vepra



QKLL 2025

DHJETOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

për të cilat nuk kishte njohuri as familja e tij.

Kjo krijimtari, e zbuluar rastësisht pas vdekjes së tij të

beftë në tetor të vitit 1993, fillimisht nga i biri Edgari e më pas edhe nga lexues të një rrethi më të gjerë, do të shpërfaqte në

publik profilin e një shkrimtari me kurajë të rrallë intelektuale dhe njëkohësisht një histori të rrallë krijimi dhe qëndrese.



19 DHJETOR 2025 / LETËRSIA E AUTORËVE TË RINJ

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Shtëpitë Studio Kadare - Agolli organizuan aktivitetin me temë: "Letërsia e autorëve të rinj" ku u diskutua mes shkrimtarëve të rinj mbi letërsinë që po shkruajnë, sa ndryshon

kjo letërsi e tyre nga ajo e së shkuarës së afërt, për sfidat e autorit të ri ose atij të bashkëkohësisë, titujt e rinj etj. Aktiviteti u mbajt në mjediset e Shtëpisë Studio Kadare - Agolli.

